



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:285586

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05731528

K.Dh.Sh II.nr.550/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija-Ymeri, kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Ramush Bardiqi anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit D.D.SH.A “UDARINK COMERC”, me NUI;810168147 me seli në Pejë rr. “Faruk Zekaj”, nr.3., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Bekim Parallangaj me seli në Prizren Rruga “Ibrahim Lutfiu”, nr.16, kundër të paditurit Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “INFRAKOS” Sh.a., me NRB:70325327, me seli në Fushë Kosovë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Ruzhdi Morina, për shkak të vërtetimit të pronësisë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti i Përgjithshëm, KP.nr.46/22, të datës 22.01.2024, me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si të pabazuar ankesa e paditësit D.D.SH.A “UDARINK COMERC”, me NUI;810168147 me seli në Pejë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm, KP.nr.46/22, të datës 22.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka vendosur si në vijim;

“IREFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit D.D. SH.A.“UDARNIK COMERC”, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi ka fituar të drejtën e pronësisë

mbi pasurinë e paluajtshme të paditurës Hekurudhave të Kosovës “INFRAKOS” Sh.a., në ngastrën kat nr.835/2 ZK Fushë Kosovë, në sipërfaqe prej 0.18.57 ha, në bazë të ndërtimit në tokën e dikujt tjetër (token e huaj), të cilën i padituri është i obliguar të pranoj dhe të duroj, që paditësi të regjistrohet si pronar ligjor në evidencën kadastrale të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Prishtinës.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale”

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditësi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ta aprovoje në tërësi si të bazuar ankesën e paditësit, të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja i kthehet të njejtës Gjykatë për rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqit paditësi me të cilën ka kërkuar që të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, përgjigjën në ankesë, provat veç e veç si dhe lidhshmërin e tyre, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 505.1 të LPK-së, gjeti se: Ankesa e paditësit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi D.D.SH.A “UDARINK COMERC, me NUI;810168147 me seli në Pejë ka paraqitu padi me datën 23.03.2009 ka parashtruar padi kundër të paditurit Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “INFRAKOS” sh.a me seli në Fushë Kosovë, për kompensimin e punëve të kryera, në të cilën ka theksuar se paditësi ka lidhur kontratë për ndërtimin e objektit banesor dhe afarist P+4 në Fushë Kosovë me kompaninë e atëhershme për organizimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe shitjen e banesave të ZTP “Zeleston” në bazë të tenderit për punime ndërtimore, ndërtimtarizejtare dhe punëve instaluese. Paditësi gjatë vitit 1998-1999 i ka kryer të gjitha punët e vrazhda në ndërtimin e këtij objekti, ka theksuar se paditësi në vazhdimësi ka kontaktuar me të paditurin dhe ka tentuar që të bisedoj që të gjejnë një zgjidhje për vazhdimin e mëtutjeshëm të punimeve të këtij objekti në interes të përbashkët. Fillimisht i ka propozuar gjykatës që të obligohet i padituri që për punët e kryera në objektin afarist – banesor P+4 në Fushë Kosovë, t’ia paguaj paditësit shumën prej 300,000.00 euro. Ndërsa me

parashtrësën e datës 22.09.2009, ka bërë ndryshimin e kërkesë padisë dhe ka kërkuar vërtetimin e pronësisë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqës ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, me arsyetim se të paditurit i mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë në këtë çështje kontestimore, meqenëse e paditura nuk ka hyrë në asnjë raport detyrimor kontraktues me paditësin ngase paditësi kontratën në të cilën e mbështet kërkesën e tij e ka nënshkruar me ndërmarrjen Zelestan DDO nga Beogradi, e cila ka marrë të drejtat dhe obligimet ndaj paditësit. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe pretendimin se objekti është ndërtuar në tokën e cila ka qenë pronë e të paditurit, por nuk pat ndikim për të vendosur ndryshe ngase kërkesëpadia bazohet në kontratën me numër 20/98-76 të datës 28.04.1998, e cila si palë kontraktuese ka paditësin si punë kryes ndërsa si investitor Zelestan DDO- Beograd, ndërsa në asnjë raport juridiko-kontraktues, nuk është përfshirë i padituri “Hekurudhat e Kosovës” sh.a me seli në Fushë Kosovë, e cila do të kishte raporte detyrimi ndaj paditësit dhe me as një provë nuk është vërtetuar se Hekurudhat e Kosovës” sh.a me seli në Fushë Kosovë janë trashëgimtar i Zelestan DDO- Beograd. Gjykata lidhur me vlerësimin e legjitimitet real pasiv të palës së paditur, është mbështet edhe në vendimet e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV.C.nr.211/2009 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ae.nr.172/2009, me të cilat vendime është vërtetuar se për objektin e kontestit në mesë palëve të njëjtë, e paditura nuk kanë legjitimitet pasiv për të qenë palë në procedurë. Krejt në fund gjykata ka vlerësuar se me nenin 7.1. lidhur me nenin 319 të LPK-së palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e tyre, të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla dhe barra e të provuarit të fakteve në të cilat pala i bazon pretendimet e tija bie mbi atë palë. Andaj, me faktin se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën vërtetohet se e paditura është trashëgimtare e Zelestan DDO- Beograd, gjykata e shkallës së parë vlerësoj se të njëjtës i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta

materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e paditurës me shkeljet e dispozitave të LPK-së konkretisht neni 182 par 2 nënparagrafi n) por të njëjtat janë të pa bazuar për shkak se janë të pa bazuar për shkak se dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e të paditurit lidhur me të drejtën materiale, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse, nga provat e administruara gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe të drejtën materiale, kur ka gjet; se nga kontrata me nr.20/98-76 të datës 28.04.1998 e cila si palë kontraktues është paditësi në cilësinë e punëkryesit ndërsa si investitor është Zelestan DDO-Beograd, ndërsa në asnjë raport juridiko-kontraktues nuk është përfshirë i padituri “Hekurudhat e Kosovës” sh.a me seli në Fushë Kosovë, e cila do të kishte raporte detyrimi ndaj paditësit dhe se me asnjë provë nuk është vërtetuar se Hekurudhat e Kosovës sh.a me seli në Fushë Kosovë janë trashëgimtar i Zelestan DDO-Beograd.

Kështu, Kolegji i Dhomë së Shkallës së Dytë i mbështet arsyetimet e dhëna në aktgjykimin e ankimuar lidhur me pretendimet e paditësit D.D.SH.A “UDARINK COMERC”, por edhe njëherë gjykata e Dhomës së Shkallës së Dytë e rithekson se pretendimet e paditësi në rastin konkret janë të pa bazuar, ngase sipas shkresave të lëndës me të cilat disponon kjo gjykatë si investitor për ndërtimin e objektit në fjalë është ndërmarrja themelore shoqërore Zelestan me seli në Beograd, lidhur me këtë investitor-ndërmarrje shoqëror Zelestan gjykata nuk posedon dhe nuk ka poseduar provë materiale për ekzistimin e saj apo mosekzistimin e saj gjatë kësaj kohe së zhvillimit të procedurës. Paditësi është i obliguar që gjykatës ti ofroj prova lidhur me ekzistimin apo mosekzistimin e investitorit i cili edhe konsiderohet si porositës i ndërtimit të ndërtesës në fjalë. Për faktin se në shkresa të lëndës dhe kontratës së lidhur në mesë të investitorit dhe punëkryesit, në rastin konkret legjitimitetin për padi e ka investitori ndërmarrja publike Zelestan me seli në Beograd, ndërsa punëkryesi nuk ka legjitimitet aktiv për kërkesat e saj ndaj Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës “INFRAKOS” sh.a me seli në Fushë Kosovë. Andaj kjo gjykatë pajtohet në tërësi me vendimin e marrë nga gjykata e shkallës së parë dhe arsyet e cekura në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar.

Andaj, krejt në fund bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh II.nr.550/24 dt.23.05.2024

Kryetarja e kolegjit
Franciska Zhitija-Ymeri